

Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo 11 201 /34

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 29 Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka mera National Agency for Protection of Personal Data

REFUBLIAN E ROSOVES REPUBLIKA KOSOVA-RE

ACH MCIA SHTETERORE PER MERCITIEN ETE OHENAVE PERSONALE

DRŽAVNA ASENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA NATIONAL AGENCY FON PROTECTION OF PERSONAL DATA

> Nr. 21 / 12 Datë: 13.09.2012

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 4, dhe nenit 49 nënparagrafi 1.5 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i Agjencisë mori këtë:

VENDIM

- Këshillohet Banka Qendrore e Kosovës BQK që në Regjistrin e Kredive të Kosovës të eliminoj të gjitha parregullsitë e bëra të të dhënave personale, në raportet individuale të transaksioneve kreditore të prezantuara nga ana e Institucioneve Bankare dhe Mikrofinanciare.
- Këshillohet Banka Qendrore e Kosovës BQK që të pamundësoj prezantimin e të dhënave të më shumë se një personi me të njëjtin numër identifikues personal, në raportet individuale të transaksioneve kreditore nga ana e Institucioneve Bankare dhe Mikrofinanciare.
- Të njoftohet Agjencia brenda 30 ditëve lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimit.
- 4. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

Arsyetim

Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror me rastin e inspektimit te kontrolluesit Besëlidhja/Zavet Mikrofinance (në tekstin e mëtejmë BZMF), ka konstatuar se në tri raportet individuale të transaksioneve kreditore (në tekstin e mëtejmë RITK) me numër identifikues të kredisë; PR08439; PR08451; PR08453;, janë prezantuar të dhëna te dy personave me te njëjtin numër identifikues personal.

BZMF në Regjistrin e Kredive të Kosovës të Bankës Qendrore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë BQK) ka prezantuar të dhënat në RITK me numër identifikues të kredisë; PR08439; PR08451; PR08453, si garantues Ymer Zymberi me numër identifikues personal 1174898215. Numri identifikues personal dhe të gjitha të dhënat e tjera të prezantuara në RITK janë të pasakta, ngase garantues në këto dy hua-kredi është Shkumbin Zymberi me numër identifikues personal 1174898215. Gjersa ne hua- kredinë e prezantuare me numër PR08439, nuk është fare garantues.

Nga të dhënat e gjetura, mundë të konstatojmë se të dhënat personale të prezantuar në Regjistrin e Kredive të Kosovës në BQK, nuk janë te sakta. Që bie ndesh me dispozitën ligjore te nenit 3 paragrafi 4, ku precizohet se të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara. Duke ditur se në bazë të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në nenin 2 nënparagrafi 1.2 "Përpunim i të dhënave personale - është çdo veprim ose një sërë veprimesh të cilat kryhen në të dhënat personale, qoftë me ose pa ndihmën e mjeteve automatike, siç janë: grumbullimi, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatshmëria ose ndryshimi, korrigjimi, konsultimi, përdorimi, zbulimi përmes transferimit, shpërndarjes ose mënyrave tjera të vënies në dispozicion, bashkimi ose kombinimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi", atëherë është detyrë dhe përgjegjësi e BQK-se qe të dhënat në regjistrin e kredive të Kosovës të jenë të sakta dhe ato të mbahen të përditësuara. Prandaj këshillojmë BQK-në të ndërmarr masat e nevojshme me qellim te verifikimit të saktësisë të të dhënave personale te prezantuara nga ana e institucioneve bankare dhe mikrofinanciare, dhe të përditësoj të dhënat aktuale.

Njëkohësisht për të evituar mundësin e prezantimit të të dhënave personale të personave të ndryshëm me të njëjtin numër identifikues personal, këshilloj që të ndërmerren masat, duke shfrytëzuar mundësit të cilat ofron teknologjia informative, të cilat do të pamundësonin prezantimin e të dhënave personale të më shume se një personi me te njëjtin numër identifikues ne RITK të Regjistrit të Kredive te Kosovës.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vendimi i dërgohet:

- Banka Qendrore e Kosovës BQK
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë

1 rator lus Mentor Hoxhaj

Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror